



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabus i lëndës Kontabiliteti Menaxherial

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Departamenti:	Menaxhim Biznesi; Koncentrimi: Banka dhe Financa
Titulli i lëndës:	Kontabiliteti menaxherial
Niveli:	BSc.
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (semestri V)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Njësia akademike:	
Përshkrimi i lëndës	Kontabiliteti i menaxhmentit është lënda e dytë në listën e lëndëve që ofrohen nga fusha e kontabilitetit që i dedikohet shfrytëzuesve të brendshëm të kompanisë. Kjo lëndë është për studentët e studimeve bachelor – viti i tretë. Lënda është e orientuar në njohjen tuaj me raportet e brendshme më të avancuara që i përgatit kontabiliteti për nevoja të menaxhmentit
Qëllimet e lëndës:	Kontabiliteti i menaxhmentit është i dedikuar për përgatitjen e informatave të nevojshme për menaxhmentin. Qëllimi i lëndës konsiston në njohjen e veglave të kontabilitetit të menaxhmentit që përdoren në raste të ndryshme të vendim marrjes. Ekzistenca e kontabilitetit të menaxhmentit është domethënëse për shkak të rolit të tij në marrjen e vendimeve afariste dhe zgjidhjen e shumë paqartësive afariste. Gjithsesi kuptimi themelor i kontabilitetit është ndihma në marrjen e vendimeve por në rastin e kontabilitetit të menaxhmentit theksi është në marrjen e vendimeve për shfrytëzues të brendshëm. Materialet janë të aplikueshme jo vetëm për biznesin por edhe për situata tjera që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e informatave të efikasitetit dhe efektivitetit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: ▪ Të kuptoni menaxhimin dhe klasifikimin e kostove,

	▪ Të kuptoni procesin e kalkulimit të kostos për forma të ndryshme të prodhimit dhe të përcaktoni pragun e rrezikut, ▪ Të përcaktoni performancën e biznesit përmes sistemit të përlogaritjes variabile, ▪ Të kuptoni kostot relevante dhe procesin e marrjes së vendimeve në afat të shkurtër, ▪ Të përcaktoni koston standarde dhe shmangiet nga këto kosto, ▪ Të përpiloni dhe analizoni pasqyrën e rrjedhjes së parasë dhe efektet e këtyre analizave në performancën e biznesit.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Detyra shtëpie	1	15	15
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	1	5	5
Totali			125
Metodologjia e mësimëdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjësuar		
Metodat e vlerësimit:	• Kollokviumi I: 0 - 50% • Kollokviumi II: 0-50% • Provimi përfundimtar 0- 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Lindita Lati & Manjola Naço – “Kontabiliteti i drejtimit”, OMSCA 1 Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës		

Literatura shtesë:	1. Garrison, Noreen, Brewer: "Management accounting" McGraw – Hill, New York, 2010; 2. Wild & Shaw: "Managerial accounting", 2010 Edition, McGraw – Hill/Irwin, New York; 3. Hansen&Mowen: "Menaxhimi i kostos: Kontabilitet dhe kontroll" – botim i përkthyer, 2009.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Pasqyrë përmbledhëse e përmbajtjes së lëndës – Ligjeratë hyrëse
Java e dytë:	Roli i kontabilitetit menaxherial në njesinë ekonomike
Java e tretë:	Klasifikimi i kostos dhe i të ardhurave për vendimarrje dhe planifikim
Java e katërt:	Analiza e kostove mikse
Java e pestë:	Analiza kosto – vëllim – profit, një mjet i rëndësishëm për marrjen e vendimeve (I)
Java e gjashtë:	Analiza kosto – vëllim – profit, një mjet i rëndësishëm për marrjen e vendimeve (II)
Java e shtatë:	Kollokviumi i parë
Java e tetë:	Marrja e vendimeve në bazë të kostove relevante dhe jo relevante
Java e nëntë:	Marrja e vendimeve në bazë të kostove oportune
Java e dhjetë:	Vendimet për zëvendësimin e makinerive në përdorim
Java e njëmbëdhjetë:	Informacioni kontabël për vendimet mbi çmimet
Java e dymbëdhjetë:	Vendimet mbi investimet e kapitalit
Java e trembëdhjetë:	Kollokviumi i dytë
Java e katërbëdhjetë:	Buxhetimi një mjet i rëndësishëm i drejtimit
Java e pesëmbëdhjetë:	Buxhetet fleksibël dhe kontrolli

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së.

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.